



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:188419
Datë: 07.02.2024
Numri i dokumentit: 05294868

Ac.nr.1939/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët: Naime Ahmeti kryetare e kolegjit, Lumni Sallauka dhe Kujtim Pasuli, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit E.Ll., nga fshati M....., Komuna Prishtinë, të cilit e përfaqëson me autorizim H.A., avokate nga Prishtina, kundër të paditurës SH.A. ‘T.....’ me seli në Mitrovicë, të cilën me autorizim e përfaqëson përfaqësuesi ligjor i të paditurës E.B., për kompensimin e shpërblimit jubilar, duke vendosur sipas ankesës të ushtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i paditësit, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Graçanicë, C.nr.189/2020, të datës 18.07.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 06.02.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e paditësit E.Ll., nga fshati M....., Komuna Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Graçanicë, C.nr.189/2020, të datës 18.07.2022, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar ka vendosur si vijon:

“REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit E.Ll., nga fshati M....., me të cilën ka kërkuar që të obligohet e paditura SH.A. ‘T.....’ me seli në Mitrovicë, të paguaj në emër të dy shpërblimeve jubilarë, shumën prej 649.00 €, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e parashtrimit të padisë deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, si e pabazuar.

Secila palë në procedurë i bartë shpenzimet e veta''.

Kundër këtij aktgjykimi e autorizuar e paditësit në afatin e paraparë ligjor ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të LPK-së, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj si të bazuar, aktgjykimin e atakuar ta ndryshoj, ashtu që të aprovoj si të bazuar kërkesëpadinë e paditësi dhe të detyroj të paditurën t'ia shpërblej kompensimin jubilar paditësit, me kamatë si dhe shpenzimet e procedurës.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- **Ankesa është e pathemeltë.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi përmes përfaqësueses të autorizuar, në gjykatën e shkallës së parë ka ushtruar padi me datë 30.12.2020, kundër të paditurës SH.A. "T....." me seli në Mitrovicë, për pagesën e dy shpërblimeve jubilarë, në vlerë prej 649.00 €, duke u bazuar në nenin 52 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 dhe paragrafi 2 të Kontratës së Përgjithshme Kolektive të Kosovës.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor të çështjes dhe administrimit të provave në shkresa të lëndës, e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe ka vendos që secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm përkitazi me vendosjen si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, dhe as në shkeljet nga nenit 182 paragrafi 2 pika b), g), j), k), n) dhe m), të LPK-së për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare dhe rrjedhimisht nuk ka aplikim të gabuar të drejtës materiale.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditësit për gjendjen faktike të vërtetuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë, për arsye se sipas vlerësimit të kësaj gjykate, gjykata e shkallës së parë e ka vërtetuar plotësisht dhe në mënyrë të drejtë gjendjen faktike, e cila ka mbështetje të plotë në provat nga shkresat e lëndës dhe në ligj, ku edhe janë dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat kanë pasur ndikim në mënyrën e tillë të vendosjes sipas aktgjykimit të ankimit, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, me çka drejtë ka ardhur edhe gjer te aplikimi i të drejtës materiale.

Gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë, pasi që nuk ishte kontestuese se paditësi është në marrëdhënie pune te e paditura sipas vërtetimit nr.649 të datës 06.11.2020, prej 01.02.2007 dhe ka 12 vite e 11 muaj stazh të punës, ku 10 vjet jubilarë të stazhit të pandërprerë

të punës i ka arritur në vitin 2017, dhe nuk ishte kontestuese se e paditura nuk ia ka kompensuar paditësit shpërblimin jubilar, mirëpo si çështje kontestuese ishte baza juridike e kërkesëpadisë së paditësit lidhur me kompensimin e dy pagave jubilarë nga e paditura. Lidhur me vendosjen si në dispozitiv të aktgjykimit ankimor, gjykata e shkallës së parë i është referuar dispozitës së nenit 90 par.4 të Ligjit të Punës me të cilin është e përcaktuar se: ‘‘Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet’’. Ndërsa që Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive ka hyrë në fuqi nga data 01.01.2015 dhe ka pasur shtrirje kohore të zbatimit deri me datë 31.12.2017, andaj duke pas parasysh faktin se paditësi padinë e ka ushtruar me datë 30.12.2020, rrjedhimisht gjykata ka vërtetuar se padia e paditësit është paraqitur pas skadimit të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës.

Në këtë drejtim edhe Gjykata e Apelit e përkrah mendimin e gjykatës së shkallës së parë të dhënë në aktgjykimin e atakuar, se kërkesëpadia e paditësit është e pathemeltë, duke pas parasysh faktin se Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës ka filluar të zbatohet nga data 01.01.2015 me kohëzgjatje të zbatimit për tri vite, përkatësisht deri me datën 01.01.2018, duke qenë se paditësi ka ushtruar padi me datë 30.12.2020, e njëjta është paraqitur pasi që ka pushuar së zbatuari MPKK, edhe për faktin se paditësi kërkon pagesën e dy pagave jubilarë, ndërsa që 10 vjetorin, jubileun e parë e ka arritur në vitin 2017, andaj në asnjë mënyrë nuk plotësohen kushtet ligjore për pagesën e dy shpërblimeve jubilarë.

Rrjedhimisht të drejtë kjo gjykatë e vlerëson përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë kur e njëjta me rastin e vendosjes sipas aktgjykimit të ankimuar ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit, në bazë të provave të administruara nuk ka dal e bazuar në ligj dhe si e tillë duhet refuzuar, ngase edhe kjo gjykatë me shikim në shkresat e lëndës konstaton se në bazë të provave të cilat janë administruar gjatë shqyrtimit kryesor paditësi nuk ka mundur ta provojë të drejtën e tij të pretenduar sa i përket themelësisë së kërkesëpadisë.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat pretendime nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e paraqitura më lart e në pajtim me dispozitën e nenit 194, 195 paragrafi 1 pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.1939/2023, me datë 06.02.2024

Kryetare e Kolegjit
Naime Ahmeti d.v